REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 01/3
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot.Nr.: 4467
Data / Datum / Date: 02.12.25
PRISHTINË / PRIŠTINA NO.1

N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01-4392 Dt. 02.12.2025
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Duke u bazuar në kompetencat dhe autorizimet e Bordit të Drejtorëve që dalin nga neni 21 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111, si dhe duke u mbështetur në Konkursin Nr.10/2260 të datës 21.09.2022 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A., në të cilin është paraparë mundësia e vazhdimit të mandatit pas përfundimit të mandatit fillestar, si dhe në pajtim me Statutin e N.P.H "Ibër-Lepenc" Sh.A., Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.12.2025, pas vlerësimit të performancës së Kryeshefit Ekzekutiv, mori këtë:

VENDIM

I. Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A., z. Faruk Mujka, i vazhdohet mandati në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv edhe për një periudhë tre (3) vjeçare, e cila fillon nga data **05.12.2025** dhe përfundon më **04.12.2028**, me mundësi vazhdimi bazuar në vlerësimin e performancës së përgjithshme nga Bordi i Drejtorëve.

II. Z. Faruk Mujka do të vazhdojë ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A. për periudhën trevjeçare, duke filluar më datë **05.12.2025**

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij, me aplikim nga data 05.12.2025.

Arsyetim

Vendimi për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv është marrë pas një analize të thelluar të performancës së përgjithshme të ndërmarrjes dhe të menaxhimit të saj gjatë mandatit të parë.

Gjatë mandatit të z. Faruk Mujka, N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A. ka realizuar performancë të qëndrueshme dhe pozitive, duke arritur rezultate të dukshme në përmirësimin e shërbimeve, stabilitetin financiar dhe menaxhimin efektiv të resurseve njerëzore, teknike, administrative dhe operacionale.

Udhëheqja e bazuar në rezultate dhe efektivitet e Kryeshefit Ekzekutiv ka kontribuar në rritjen e efikasitetit organizativ dhe arritjen e objektivave korporative të ndërmarrjes.

Bazuar në konkursin publik Nr.10/2260 të datës 21.09.2022 për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A., në të cilin është paraparë mundësia e vazhdimit të mandatit pas përfundimit të mandatit fillestar, Bordi i Drejtorëve, në bazë të vlerësimit të performancës së deritanishme, ka ushtruar të drejtën për zgjatjen e mandatit të tij, duke garantuar kontinuitetin dhe stabilitetin në menaxhimin e ndërmarrjes.

Bajram MUSTAFA

Kryesues i Bordit të Drejtorëve i
N.P.H. "Ibër Lepenc", Sh.A.

Dërguar:

- Bordi i Drejtorëve / Sekretarit të Ndërmarrjes;
- Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve;
- Z. Faruk Mujka;
- Zyrtari Kryesor Financiar;
- Burimeve Njerëzore;
- Arkivi i N.P.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A.;

Insajderi Gazetë online